



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK**

Numri i lëndës: 2024:236727

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06578540

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë jo kontestimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar individual, me zyrtaren ligjore Blerina Berisha, në lëndën jo kontestimore të propozuesit H. (M.) T. nga fshati Soponice, Rr.”..., Komuna Kaçanikut, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat H. L. nga Kaçaniku, duke vendosur lidhur me konstatimin e vdekjes së personit M. (R.) T., e vajzërisë R., nga fsh. Soponicë, Komuna Kaçanik, pas mbajtjes së seancës gjyqësore më datën 04.12.2024, ndërsa me datën 11.12.2024 bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET në tërësi si i bazuar Propozimi i propozuesit H. T. nga Komuna Kaçanikut, dhe VËRTETOHET se:

- M. T. e vajzërisë R., nga fshati Soponicë, Komuna e Kaçanikut, e lindur më datën 05.06.1906 ne fshatin .., Komuna e Ferizaj, nga i ati R. R. dhe e ëma P. R., ka vdekur më datën 21.01.2011, në fshatin ..., Komunën e Kaçanikut, për shkak të moshës së pleqërisë, pra nga vdekja natyrore, dhe është varrosur ne varrezat e fshatit Soponicë te qytetit të Kaçanikut.

II. DETYROHET Shërbimi i Gjendjes Civile në Kaçanik që të bëj regjistrimin në librin amë të vdekjes, sipas këtij aktvendimi.

III. Ky aktvendim është i formës së prerë që nga data 04.12.2024, ndërsa shpenzimet për taksë i ka paguar pala propozuese, me rastin e dorezimit te propozimit ne gjykate.

**A r s y e t i m**

Propozuesi në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik më datën 28.08.2024, e ka dorëzuar propozimin, me të cilin ka kërkuar që të konstatohet vdekja e M. (R.) T. e lindur R., nga fshati Soponicë, Komuna e Kaçanikut, sepse e njëjta ka vdekur për shkak të moshës së pleqërisë nga vdekja natyrore, e cila nuk është regjistruar në Librin Amë të të Vdekurve ( LAV ) në Kaçanik.

Gjykata e ka caktuar seancën gjyqësore për datën 04.12.2024, në këtë seancë i autorizuari i propozuesit, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në propozimin me shkrim dhe i ka propozuar gjykatës që propozimi të miratohet në tërësi si i bazuar, dhe të vërtetohet se M. T. e lindur R., nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, e lindur më datën 05.06.1906 në fshatin ..., Komuna e Ferizaj, nga i ati R. R. dhe e ëma P. R., ka vdekur më datën 21.01.2011, në fshatin ..., Komunën e Kaçanikut, për shkak të moshës së pleqërisë, pra nga vdekja natyrore, dhe është varrosur në varrezat e fshatit ... të qytetit të Kaçanikut. Tutje ka theksuar se tani e ndjera nuk është regjistruar në Librin Amë të Gjendjes Civile të Vdekjes në Komunën e Kaçanikut, dhe vdekja faktike e saj nuk mund të provohet me asnjë dokument të parashikuar me ligj.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe për të gjykuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje jo kontestimore të konstatimit të faktit të vdekjes, gjykata bëri administrimin e këtyre provave edhe atë i lexoi: Ekstrakti i gjendjes civile me nr.E ... për H. T., Letërnjoftimi i M. T. i leshuar nga UNMIK-u, Letërnjoftimi i H. T., Vërtetim nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme Ferizaj nr. 02.200, i datës 27.08.2024, Deklarata nën betim me nr.rendor : 2283/2024, i datës 22.08.2024, Deklaratat e dëshmitarëve të dhëna drejtëpërdrejtë në këto seance të E. T. dhe S. T. si dhe Dokumentet identifikuese të E. T. dhe S. T., pa pyetje dhe pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe profesionalizëm të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkarisht, e në bazë të dispozitave të nenit 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatës, kjo gjykatë për këtë çështje jo kontestimore vërtetoi këtë gjendje faktike:

Personi M. T., nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, e lindur më datën 05.06.1906 në fshatin ...- K. Ferizaj, ka vdekur më datën 21.01.2011, në fshatin ..., Komunën e Kaçanikut, për

shkak të moshës së pleqërisë, pra nga vdekja natyrore dhe e njëjta është varrosur në qytetin e Kaçanikut, varrezat e fshatit ..., e njëjta nuk është regjistruar në librin amë të të vdekurve.

Nga Letërnjoftimi i M, T, i leshuar nga UNMIK-u dhe nga Vërtetimi nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme Ferizaj nr. 02.200, i dates 27.08.2024, vërtetohet fakti se personi M, T. e lindur R., ka lindur me datë 05.06.1906 ne fshatin ...- K. Ferizaj, nga i ati R. R. dhe e ëma P. R..

M. T. ka vdekur më datën 21.01.2011, në fshatin ..., Komunën e Kaçanikut, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga Deklarata nën betim me nr.rendor : 2283/2024, i datës 22.08.2024 e N. Sh. dhe V. I. te cilet kane deklaruar se te ndjeren M. T.e lindur ne ..., Komunen e Ferizaj, me daten 05.06.1906, ka vdekur me daten 21.01.2011, ne fshatin Saponice- Komuna e Kaçanikut, per kete jane ne dijeni sepse e njohin familjarisht dhe kane qene prezent ne ceremonine e varrimit.

Gjykata ne cilesine e deshmitareve ne seancen e dates 04.12.2024, ka degjuar E. T. dhe S. T. te dy nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, te cilet kane deklaruar se te ndjeren e kane njohur dhe e kane familjare te afert, ne ditën e vdekjes kane qene ne ditën e varrimit te saj, dhe e mbajn mend mire, kane qene ne te pame, dhe derisa eshte mbyllur e pamja kane qene prezent. Ka qene sezone e dimrit e muajit Janar perkatsisht me 21.01.2011 ne varrezat e fshatit Saponice- Komuna Kaçanikut.

Gjykata, pas analizimit të propozimit, deklaratave të dëshmitarëve të dhëna nën betim, deklaratave të drejtpërdrejta në seancë dhe provave të tjera të administruara që gjenden në shkresat e lëndës, aprovoi kërkesën e propozuesit. Nga provat e shqyrtuara u vërtetua se personi M. T., e lindur R., nga fshati ... i Komunës së Kaçanikut, e lindur më 05.06.1906 në fshatin ..., Komuna e Ferizajt, nga i ati R. R. dhe e ëma P. R., ka ndërruar jetë më 21.01.2011 në fshatin Saponicë të Komunës së Kaçanikut për shkak të moshës së pleqërisë, pra nga vdekje natyrore, dhe është varrosur në varrezat e fshatit Saponicë. Këtyre provave gjykata u dha besimin, pasi ato vërtetuan faktet e përmendura ne propozim.

Prandaj gjykata duke i pas për bazë këto fakte të konstatuara si dhe konform nenit 21 të Urdhëresës Administrative 24/215/ARC.MPB dhe konform neneve 64, 73 dhe 74 të Ligjit të procedurës jokontestimore vendosi si më lartë.

Gjykata sa i përket shpenzimeve konstatoi se propozuesi me rastin e dorëzimit të propozimit ne gjykate e ka paguar taksën gjyqësore ne shume prej 20€, konform Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore 01/2017 si dhe konform nenit 29 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore.

Ky aktvendim është i formës së prerë që nga data 04.12.2024, sepse propozuesi ka hequr dorë nga e drejta e ankesës.

Nga arsyet e përmendura si dhe konform dispozites së lartë cekur është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

CN.nr.2024:236728 e datës 11.12.2024

Gjyqtari:

Burhan Berisha